



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



Demokracia në klasë

Simulimi i zgjedhjeve

Ky material u shërben mësuesdhënësve në rast se dëshirojnë të mbajnë simulim të zgjedhjeve në klasë



Hapi i pare: Çka janë zgjedhjet?



Mësimdhënësi i edukatës qytetare në orën mësimore për zgjedhjet iu shpjegon nxënësve kuptimin, rolin dhe organizimin e zgjedhjeve. Mësimdhënësi i njofton nxënësit që si shembull praktik do të bëjnë simulimin e zgjedhjeve.



Çdo demokraci ka nevojë që herë pas here të testojë funksionalitetin dhe efikasitetin e institucioneve të saj, e zgjedhjet janë ato që pikërisht e mundësojnë këtë. Si një prej instrumenteve më të rëndësishme të demokracisë sot, zgjedhjet shërbejnë si rrugë për pjesëmarrje të qytetarëve në procese politike. Duke i zgjedhur përfaqësuesit që përfaqësojnë më së miri vlerat dhe interesat e popullit, votuesit mund të ndikojnë në formësimin e politikave që përmirësojnë kualitetin e jetës së tyre.



Hapi i dyte: Ndarja e roleve

- **Kryesuesi i Vendvotimit** - koordinon dhe menaxhon punën e anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit
- **Kontrolluesi i Rreshtit** - qëndron te dera me elektrik dore dhe kontrollon gishtërinjtë për shenja nga spreji që vendoset kur voton
- **Zyrtari i Identifikimit** - kontrollon letërnjoftimin dhe e verifikon emrin e votuesit në listën e votuesve ku pastaj votuesi nënshkruan
- **Dhënësi i Fletëvotimit** - I spërkat gishtin me sprej votuesit, e vulos fletëvotimin dhe ia jep atë votuesit
- **Mbikëqyrësi i Kutisë së Vendvotimit** - mbikëqyr kutinë e votimit
- **Vëzhguesit** - (prej 1 deri në 5 persona) vëzhgojnë të gjithë procesin në vendvotim



Përgjegjësitë e zyrtarëve në vendvotim

Kryesuesi i vendvotimit:

- Siguron përgatitjen dhe rregullimin adekuat të Vendvotimit.
- Eksponon kutitë e zbrazëta të votimit para të gjithë personave të pranishëm në vendvotim.
- Mbyll kutitë e votimit me shirita mbyllës të sigurisë dhe i vendos ato në vendin ku shihen plotësisht nga të gjithë të pranishmit në Vendvotim.
- Siguron që të gjithë formularët e nevojshëm të jenë në Vendvotim dhe të plotësohen në mënyrë të saktë.
- Mbikëqyr procesin e numërimit nga anëtarët dhe siguron aplikimin e procedurave të numërimit në përputhje me Ligjin.

Mbikëqyrësi i kutisë së votimit:

- Siguron që votuesit të votojnë me radhë dhe të gjithë t'i hedhin fletëvotimet e tyre në kuti
- Kontrollon kabinën e votimit që të gjitha materialet e nevojshme të jenë në vend (stilolapsi dhe lista e kandidatëve)



Kontrolluesi e rreshtit:

- Qendron në hyrje të vendvotimit
- Siguron që nuk ka shumë votues brenda në vendvotim
- I udhëzon votuesit që të kenë dokumentet e duhura me vete për të votuar (letërnjoftim valid, pasaportë valide, patentëshofer valid)
- Kontrollon gishtat me elektrikun UV për të parë nëse janë me ngjyrën e padukshme të sprejit

Zyrtari për identifikim:


- Verifikon identitetin e votuesit nga Lista e Votuesve
- Gjen emrin e votuesit dhe udhëzon atë që të nënshkruajë tek emri dhe e drejton atë tek dhënësi i fletëvotimit

Dhënësi i fletëvotimit:

- Spërkat gishtin e djathtë tregues me sprej me ngjyrë të padukshme
- Shkëput nje fletëvotim e palos atë, e vulos dhe ia dorëzon votuesit duke e udhëzuar tek kabina për votim

Ky material u shërben mësimdhënësve në rast se dhëshirojnë të mbajnë simulim të zgjedhjeve në klasë

Hapi i tretë: Procesi i votimit



Ky material u shërben mësimdhënësve në rast se dëshirojnë të mbajnë simulim të zgjedhjeve në klasë

Hapi i katërt: Mbyllja e vendvotimit dhe numërimi i votave

Kryesuesi i KVV-së do t'i caktojë anëtarët e KVV-së për të kryer detyrat e mëposhtme:

- Menjëherë të mbyllen vrimat e kutisë së votimit.
- Shënon në Librin e Votimit kohën e mbylljes së vendvotimit dhe emrat e personave të pranishëm në vendvotim
- Qëndron te dera dhe i monitoron të gjithë personat që hyjnë në vendvotim dhe që largohen nga vendvotimi



Anëtarët e tjerë do t'i kryejnë këto detyra:

- Numërohen nënshkrimet e votuesve nga lista
- Numërohen fletëvotimet e papërdorura. Numërohen për të dytën herë nga anëtari tjetër i vendvotimit – në këtë fazë nuk lejohet asnjë mospërputhje!
- Numërohen fletëvotimet e dëmtuara dhe shënohet sasia e tyre. Numërohen për të dytën herë nga anëtari tjetër i qendrës – në këtë fazë nuk lejohet asnjë mospërputhje!

Numërimi i fletëvotimeve

- Fletëvotimet shpalosen duke i vënë përmbys
- Të gjitha fletëvotimet numërohen dy herë
- Në mbikëqyrje të plotë të Kryesuesit të KVV-së, fletëvotimet kthehen mbarë dhe klasifikohen në: fletëvotime të vlefshme, fletëvotime të paplotësuara dhe fletëvotime të pavlefshme
- Numerohen fletëvotimet me kandidatë dhe shënohen rezultatet në formularin e rezultateve

Fletëvotimet vendosen në kuti dhe kutia mbyllet dhe dergohet në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) e të cilët më pas të njëjtin material e dorëzojnë në KQZ

Hapi i pestë: Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

Numërimi i votave evidentohet në formularë të detajuar dhe dizajnuar nga KQZ. Për arsye simulimi, anëtarët e Këshilit të Vendvotimit (në këtë rast nxënësit të cilët marrin rolet e anëtarëve të këtij këshilli), të numërojnë votat në mënyrë krejt të thjeshtë, duke përpiluar një tabelë me dy kolona, një për partitë politike dhe tjetra për kandidatë, dhe të evidentojnë rezultatet sipas votave.



Materialet e nevojshme:

- Fletëvotimet (mund të shkarkohen në këtë link http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/100_Fletevotimi_Kuvend-Kosoves_shq-sr-tr.pdf)
- Kutia për fletëvotime
- Lista e votuesve (të simulohet/përpilohet me emra të nxënësve të cilët do të votojnë gjatë procesit simulues të votimit)
- Dokumenti identifikues (mund të punohet vetë nga letra vetëm për arsye demonstrimi)
- Spreji që vendoset në gisht për të verifikuar nëse votuesi ka votuar një herë
- Elektrik dore (që të përdoret në vend të dritës UV që tregon shenjat nga spreji)
- Kabina për votim (të pajiset me stilolaps dhe një fletë të shënohen numrat dhe emrat e kandidatëve që garojnë)
- Libri i votimit, për të evidentuar ndonjë çështje teknike eventuale gjatë procesit të votimit
- Formulari i rezultateve (një fletë e pastër ku pasqyrohen rezultatet)
- Doracaku (mund të shkarkohet në këtë link http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/Doracaku-i-trajnimet-2014_shq.pdf)

Ky material u shërben mësimeve në rast se dëshirojnë të mbajnë simulim të zgjedhjeve në klasë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS